



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA
KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA
KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVO



SEKRETARIATI - KËSHILLIT KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE
INVESTIME

PROCESVERBAL

Mbledhja e Parë

E enjte, 20 Gusht 2020, ora 11:00

Prishtinë

Mbështetur nga:



European Bank
for Reconstruction and Development



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime në Kosovë
Sekretariati i KKEI**

Mbledhja e Parë

E enjte, 20 Gusht 2020, ora **11:00**

Prishtinë

Rendi i ditës

- 11:00 – 11:10 Fjala Hyrëse – Kryeministri i Kosovës, z. Avdullah Hoti
- 11:10 - 11:30 Diskutim mbi masat e ndërmarra ndaj sektorit privat –
- Pako emergjente për biznese dhe pako e rimëkëmbjes – zv. Ministri i Financave, z. Agim Krasniqi
- Shtyllat e zhvillimit ekonomik - ndërmarrësia, energjia dhe ekonomia e gjelbërt – zv. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, z. Muharrem Nitaj
- Subvencionimi i bizneseve te vogla dhe të mesme si dhe investimet strategjike – zv. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, z. Nexhat Ramadani
- Subvencionimi i produkteve esenciale bujqësore për të siguruar qëndrueshmërinë ushqimore - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Besian Mustafa
- 11:30 – 11:40 Prezentim i Sekretariatit mbi iniciativat e Sekretariatit të KKEI lidhur me pakon e rimëkëmbjes - znj. Lindita Daija – Udhëheqëse e Sekretariatit të KKEI
- Vazhdimësia e punës se Grupit Koordinues për trajtimin dhe adresimin e çështjeve ekonomike dhe problemeve që ka sektori privat, si rezultat i përballjes me pandeminë COVID-19 - Plotësim-ndryshimi i Vendimit mbi Grupin Koordinues dhe rregullorja e KKEI
- 11:40 – 12:10 Diskutime nga Asociacionet e Bizneseve:
- Rimëkëmbja si mundësi për transformim të ekonomisë – si dhe

zingjirët global të furnizimit z. Berat Rukiqi – Kryetar - Oda Ekonomike e Kosovës

Rekomandimet për nxitjen e investimeve të jashtme, si dhe rekomandimet për përkrahjen e sektorit të prodhimit dhe sektorit të gastronomisë –
z. Arian Zeka – Drejtor Ekzekutiv - Oda Amerikane e Kosovës

Ndryshimi i ligjit për prokurimi publik, TVSH në lëndën e parë si dhe të largohet tatimi në fitim për të hyrat e gjeneruara nga eksportet – z. Astrit Panxha – Drejtor i Klubit të Prodhuesve të Kosovës

Paga minimale në Kosovë dhe falja e ndëshkimeve dhe borxheve administratave shtetërore për bizneset dhe qytetarët e Kosovës - z. Agim Shahini, Kryetar - Aleanca Kosovare e Bizneseve

Klima miqësore e investimeve për teknologji digjitale, - z. Ardian Shehu – Anëtar Bordi i Këshillit të Investitorëve Evropian

12:10 – 12:20 Diskutime tjera

12:20 – 12:25 Konkludimet e takimit – Plani i veprimit drejt rimëkëmbjes ekonomike Kryeministri i Kosovës, z. Avdullah Hoti

AVDULLAH HOTI:

I nderuar zëvendës kryeministër, ministra, zëvendësministra, drejtorë të odave ekonomike, i nderuar Guvernator, përfaqësues të shoqatave dhe përfaqësues nga Asociacioni i Komunave, Të gjithë ju që jeni prezentë,

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

Kjo është mbledhja e parë, në të cilën do të trajtojmë disa çështje në bazë të agjendës që e keni marrë. Unë dëshiroj t'ju falënderoj të gjithëve për prezencën sot, në këtë forum shumë të rëndësishëm, që është vazhdimësi e konsultimeve të rregullta që Qeveria ka pasur me sektorin privat dhe me të gjithë partnerët e përfshirë në zhvillim ekonomik dhe në investime në nivel të vendit.

Siç e keni parë, ne e kemi riemërtuar dhe e kemi riorganizuar pak këtë Këshill, me qëllim që të fokusohemi në temat e rëndësishme për zhvillimin ekonomik, por në veçanti, për t'u fokusuar nëpër këto procese të rëndësishme që po kalojmë tash si rezultat i pandemisë.

Unë dëshiroj të falënderoj BERZH-in dhe Zyrën Qendrore të BERZH-it, për mbështetjen që po na jep në këtë Këshill përmes ndihmës dhe mbështetjes në organizimin e Sekretariatit të këtij Këshilli, i cili është duke e bërë një punë shumë të mirë në mbledhjen e informatave dhe duke na mbajtur në linjë të komunikimit dhe të informuar gjatë gjithë kohës duke i mbledhur propozimet nga odat ekonomike, nga shoqatat, nga institucionet e ndryshme në mënyrë që të gjithë ne të jemi plotësisht të informuar për prioritetet, për zhvillimet për sfidat dhe në veçanti për sfidat që duhet t'i adresojmë së bashku.

Përmes këtij Këshilli unë besoj që do të vazhdojmë punën e mirë që është bërë edhe në të kaluarën, në mënyrë që të harmonizojmë veprimet e institucioneve shtetërore me sektorin privat dhe me partnerët e tjerë zhvillimorë që janë të përfshirë dhe që ndihmojnë në promovimin e investimeve dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës. Kjo është tepër e rëndësishme, kur ne po përballemi tash me pasojat sociale dhe ekonomike të pandemisë.

Siç e dini e kemi si pjesë të Programit Qeverisës, e kemi paraparë edhe një pako të masave të Rimëkëmbjes Ekonomike. Unë e them me kënaqësi, sigurisht brenda kapaciteteve tona që i kemi si ekonomi dhe si Qeveri, që me rishikimin e buxhetit ne kemi formuar Fondin për Rimëkëmbje Ekonomike prej 365 milionë euro dhe në vendimin e Qeverisë të para një jave e kemi shpërndarë këtë fond nëpër masa të ndryshme, siç e keni parë.

Tash, në periudha afatshkurta që nënkupton menjëherë në javët dhe muajt e ardhshëm, duhet të punojmë bashkë me juve që të zbatojmë në praktikë, të implementojmë këtë pako të Rimëkëmbjes Ekonomike, përmes masave të ndryshme.

Siç e keni parë në vendimin e Qeverisë, në aneks tabelën ku janë të përshkruara të gjitha vendimet është i ndarë edhe roli i të gjitha institucioneve publike, por edhe i partnerëve zhvillimorë dhe i odave ekonomike.

Atë që dëshiroj t'ju garantoj është që do të jeni plotësisht të përfshirë në zbatimin në praktikë të pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Çka nënkupton kjo? Kjo nënkupton që në secilën prej masave ministrat përkatës janë duke i bërë përgatitjet e nevojshme që nënkupton nxjerrjen e udhëzimeve, dokumenteve ose kriterëve në bazë të cilave i shpërndajnë fondet për subvencionim të pagave ose për mbulim të normës së interesit, ose për subvencione të ndryshme, ndihmë të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

Ju do të jeni të përfshirë edhe në përgatitjen e kriterëve për shpërndarjen e këtyre fondeve, edhe në komisionet vlerësuese për shpërndarjen e atyre fondeve, sepse ne dëshirojmë të sigurohemi që duke qenë se janë para publike të shpërndahen në transparencë të plotë, por mbi të gjitha të shkojnë në vendin të kompanitë, në ndërmarrjet, të punëtorët ku japin efektin maksimal dhe askush më mirë sesa ju nuk i din nevojat e ekonomisë dhe nevojat e bizneseve.

Kjo është e para, e dyta, ne edhe ashtu kemi pasur në plan që në shtator të fillojmë draftimin e strategjisë të re zhvillimore për Kosovën, por tash jemi të nxitur dhe të shtyrë nga nevojat që kemi për të ofruar një plan afatgjatë të rimëkëmbjes ekonomike, sepse është më se e qartë që ne do të përballemi me probleme të rimëkëmbjes ekonomike jo vetëm brenda këtij viti, por jam i sigurt komplet gjatë vitit të ardhshëm e ndoshta përtej saj, sepse kohëzgjatja e kësaj pandemie nuk është se ka krijuar disa vështirësi afatshkurtra të likuiditetit të bizneseve, por është e qartë që ka shkaktuar shkundje, trandje afatgjate të ekonomisë dhe të bizneseve nëpër sektorë të caktuar dhe ne tash duhet të kemi një qasje pak më afatgjate.

Çka nënkupton kjo për ne? Nënkupton një strategji zhvillimore 5-vjeçare e cila neve na mundëson që të mobilizojmë siç kemi mobilizuar këto fonde nga buxheti dhe nga kreditë që kemi marrë deri më tash 365 milionë euro, deri në fund të vitit 2021 të arrijmë ta rrumbullakojmë atë pakon afatshkurtër të rimëkëmbjes që shkon në 1.2 miliardë, por të fokusohemi me një plan së paku 5 vjeçar që shkon deri në 6 miliardë euro ndihmë për ekonominë, që përfshinë edhe ndihmën e drejtpërdrejtë nga buxheti edhe përmes kredive shtetërore, edhe përmes garancioneve kreditore që duhet të lëshojë qeveria për investimet private edhe mobilizim i mjeteve të donatorëve e këtu në rend të parë nënkuptoj mjetet e Komisionit Evropian, që janë bukur të mëdha për të cilat veç jemi në procedura.

Unë pres që në javën e parë të tetorit të kemi Konferencën e donatorëve për Ballkanin Perëndimor, ku i vendosim përfundimisht projektet e mëdha infrastrukturore 6 vendet e Ballkanit Perëndimor përfshirë edhe Kosovën, disa prej projekteve që i lidhin më mirë këto vende, projekte infrastrukturore kryesisht por që krijojnë efekte multiplikuese në ekonomi, që shkojnë për Kosovën besoj deri në 700 milionë euro në periudha 5 vjeçare. Janë fondet e MCC-së për të cilat jemi gjithashtu duke i finalizuar në konsultim me tri ministritë e linjës projektet që do të financohen nga MCC në vitet në vijim dhe gjithashtu nga donatorë të tjerë. Unë jam konfident që gjatë muajve shtator-tetor do të arrijmë ta rrumbullakojmë këtë çështjen e strategjisë 5-vjeçare për të mobilizuar shumë prej rreth 6 miliardë euro në mbështetje të sektorit privat.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Tash po vazhdojmë sipas agjendës që keni marrë. Me dakordimin e juaj, unë do të kërkoj nga Ministria e Financave prej së cilës është Zëvendës Ministri këtu prezent, nga Ministria

Ekonomisë dhe Ambientit, Zëvendës Ministrit z. Muharrem Nitaj, për shkak se dy ministrat nuk janë këtu, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë z. Nexhat Ramadani dhe Ministri i Bujqësisë z. Besian Mustafa.

Dhe ju kërkoj që 4 folësit të koncentroheshin në 5 minuta maksimum, në mënyrë që të krijohet hapësirë për zonjën Daija, edhe pastaj për diskutimet e bizneseve dhe shoqatave të odave ekonomike. Disa prej cilave i kemi vendosur në agjendë, po sigurisht të gjithë jeni të inkurajuar të merrni fjalën dhe të jepni mendimet e juaja, përfshirë këtu me respekt të veçantë edhe për guvernatorin e Bankës Qëndrore që e kemi prezent.

Faleminderit shumë për vëmendjen, atëherë po vazhdojmë sipas agjendës, e lus Zëvendës Ministrin Financave, z. Agim Krasniqi që të prezantoj shkurtimisht pakon emergjente për biznese dhe pakon e rimëkëmbjes.

Agim Krasniqi:

Faleminderit Kryeministër, përshëndetje Zëvendës Kryeministër, Ministra, të gjithë përfaqësues të odave. Unë do të mundohem shkurtimisht, brenda 5 minutave, të paraqes ku jemi me implementimin e pakos komplet, por edhe pakos emergjente.

Pas aprovimit të rishikimit të buxhetit, Ministria e Financave ka filluar implementimin e të gjitha masave që janë marrë më herët. Shkurt po ju njoftoj që ne në Ministrinë e Financave, më nuk kemi asnjë aplikacion të pa paguar. Kjo nënkupton që deri dje në të gjitha 15 masat që kanë qenë janë paguar 132.6 milion euro dhe kemi deri tash rreth 3100 aplikacione që kanë probleme me të dhënat si dhe presim që brenda këtyre ditëve Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Punës t'i rregullojnë, në mënyrë që këto pagesa të përfundojnë.

Ajo që mbetet për më tutje, është që një pjesë e aplikuesve kanë shfrytëzuar të drejtën e ankesës dhe komisioni po i shqyrton, ndërsa ato mbesin për më vonë.

Do të thotë pak a shumë fondet janë siguruar të gjitha. Ministrive i është rimbursuar pjesa që është paguar më herët prej linjave të tjera buxhetore, dhe në përgjithësi besoj që brenda këtij muaji, nëse edhe komisioni arrin t'i shqyrtoj të gjitha ankesat, pakoja emergjente vetëm se përfundon.

Ajo që jemi duke përgaditur ne si Ministri është që krahas pakos emergjente, të përgatitemi për pjesën e dytë që ka të bëjë me financimin e pakos për rimëkëmbje ekonomike. Normalisht, ne presim që ligji të kalojë në kuvend dhe të krijohet baza dhe infrastruktura ligjore, në mënyrë që edhe mjetet të tërhiqen. Siç janë mjetet e AKP-së dhe të krijojmë të gjithë bazën financiare për implementim të pakos së dytë financiare.

Pavarësisht kësaj, Ministria është duke punuar me akterë të caktuar, në mënyrë që të përgatitemi proceduralisht para implementimit të pjesës financiare. Kemi punuar së bashku me Fondin për Garantim të Kredive dhe do të kemi takim javën e ardhshme me BQK-në në mënyrë që të detalizojmë procedurat, të kemi informata më të plota për biznesin, që të jenë të gatshëm, që në

momentin që mjetet të jenë në dispozicion, ku pjesa e rregullt e financimit veq është në dispozicion, të kemi mundësi menjëherë t'i plasojmë, në mënyrë që mos të pritët më shumë.

Ne kemi përgatitur edhe një tabelë shtesë, ku për çdo masë jemi siguruar që të shohim edhe prej dinamikës së ministrive të linjës që të kemi njohuri se si, në çfarë forme dhe kur do të jenë të domosdoshme mjetet për alokim për Ministrinë e linjës. Po ashtu, ne jemi duke përgatitur edhe kornizën afatmesme të shpenzimeve, të rishikuar për herë të parë, në mënyrë që të përgatitemi që një pjesë e planit për rimëkëmbje ekonomike të jetë e përfshirë edhe për vitin 2021, për arsye që ne e kemi të qartë që përveq këtij 365 milionëshi, që është planifikuar për vitin 2020, do të jetë edhe një pjesë mbi 160 milion, pjesë e pakos për rimëkëmbje në vitin e ardhshëm.

Pra jemi të përgatitur që të gjitha obligimet që kemi si ministri dhe qeveri t'i përfundojmë brenda vitit 2020, por edhe 2021. Për ne është me rëndësi që ligji për rimëkëmbje ekonomike të kaloj sa më shpejtë, për arsye që në momenin që kalon ligji, atëherë te çështja e implementimit duhet shikuar se ligji përfundon me 31 dhjetor dhe ne duhet të përgatitemi për fazën e tranzicionit në rast se një pjesë e fondeve nuk mund të shfrytëzohet, të bartet në buxhetin e vitit 2021, në mënyrë që programi të realizohet plotësisht.

Kështu që, ne jemi të përgatitur. Po besoj që do të jetë shumë e rëndësishme koha dhe momenti kur ligji për rimëkëmbje do të kalojë në qeveri dhe kjo do të përcaktojë edhe dinamikën e shpenzimeve, për arsye se ne jemi të vetëdijshëm që një pjesë, për shkak të vonesës në aprovim dhe implementim të ligjit për rimëkëmbje ekonomike, mund të kemi fonde, por mund të mos shfrytëzohen dhe ne duhet të përgatitemi që në vitin 2021 të vazhdojmë me pakon për rimëkëmbje ekonomike.

Unë po besoj që çdo gjë që vjen prej ministrive, ne bashkërisht do të ulemi, për arsye që koha e ardhjes së mjeteve nuk varet krejtësisht prej burimeve të brendshme, por edhe prej atyre që përmenda më herët. Aty do të bisedojmë për dinamikën e alokimit, varësisht se cila ministri ose cili institucion është i gatshëm dhe sa ka nevojë për mjete, në mënyrë që të përgatisim infrastrukturën ligjërisht që një pjesë e këtyre mjeteve duhet bartur në buxhetin e vitit të ardhshëm kur përgatisim buxhetin e vitit 2021.

Shkurtimisht kjo ishte kryeministër. Faleminderit!

Muharrem Nitaj:

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra dhe pjesëmarrës tjerë nga sektori privat,

Aktivitetet të cilat kanë për qëllim përmbushjen e prioriteteve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, janë të parapara në Planin e punës së Qeverisë për periudhën afatmesme dhe gjithashtu në Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Ne konsiderojmë që shtyllat kryesore për zhvillimin ekonomik mbeten siguria e furnizimit me kosto të përballueshme me energji elektrike në harmoni me obligimet për mbrojtje të mjedisit, zhvillimin dhe valorizimin e resurseve minerare, krijimin e politikave të favorshme për zhvillimin e sektorit privat duke u bazuar në inovacion dhe dije, krijimin e kushteve për transformimin e ekonomisë drejt digjitalizimit (ekonomisë digjitale), rritjen e vlerës së aseteve të ndërmarrjeve publike, si dhe zbatimin e reformave strukturore në ekonomi.

Shumë prej këtyre kanë ardhur në pyetje tash në kohën e pandemisë. Ne duhet të flasim për strategji të zhvillimit ekonomik, mirëpo gjendja reale nuk është fare e favorshme.

Ne kemi pasur një besim të pashoq në pakon e rimëkëmbjes, që do të mund të na shtynte në një gjendje ku biznesi do të ndjenjtë krahun tonë. Mirëpo, sikur e dimë të gjithë, nuk është arritur që të kalohen të gjitha ligjet e pakos së rimëkëmbjes. Nuk u kalua Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike dhe Ligji për Masat Lehtësuese nga COVID-19. Kjo i bllokoi shumë linja që do të mund të funksiononin për të ringjallur zhvillimin ekonomik. Realisht, në dokumentin që e kemi këtu nga Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik mund t'i shohim rekomandimet që na kanë ardhur nga Odat dhe organizimet e sektorit privat. Shumë prej këtyre do të mund të merrnin rrugë me këto dy ligje. Por, sinqerisht është fatkeqësi që Kuvendi i Kosovës e ka përmbyllur sesionin pranveror dhe ka shkuar në pushim. Raportimet nga terreni nuk është se janë të mira për biznesin, pa çka ky është shqetësimi ynë kryesor.

Pasi si ministri kemi një spektër të gjerë të fushëveprimit, neve na është dashur që të punojmë ngushtë edhe me ndërmarrjet publike qendrore, të cilat kanë rol shumë të rëndësishëm në funksionimin e ndërmarrjeve private. Gjendja në ndërmarrjet publike nuk është e mirë dhe ka problem të shumta, mirëpo jemi siguruar që në këtë kohë pandemie t'i ndihmojmë dhe të funksionojnë si duhet.

Ajo që kemi kërkuar nga organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat në takimet e kohës, është që edhe strategjitë e tyre t'i përshtasin me këto ligje dhe programin e qeverisë për rimëkëmbje. Shumë prej tyre janë pajtuar dhe na kanë premtuar bashkëpunim.

Në fushën e energjisë, është e rëndësishme të theksohet që ne kemi themeluar grupin ndër-institucional, me qëllim të hartimit të Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës si dhe Programin për zbatimin e saj, me qëllim të përcaktimit të politikave dhe orientimeve të zhvillimit të sektorit për periudhën e ardhshme 10 vjeçare. Në anën tjetër, Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë për periudhën 2021-2030 është në proces të hartimit, dokument i cili do të përcaktoj planet në lidhje me këto dy fusha, bazuar edhe në agjendën e gjelbërt. Po ashtu, në lidhje me prioritetin e fushës së eficiencës së energjisë, jemi fokusuar në krijimin e stimujve për sektorin privat dhe amvisëri, si dhe distribuimin e mjeteve nga Fondi për eficiencë të energjisë për sektorin publik – kjo me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve dhe reduktimit të konsumit të energjisë elektrike në vend. Në fushën e zbatimit të masave të eficiencës së energjisë, përmes Fondit ne kemi shpallur thirrjen dhe komunat kanë aplikuar përmes projekteve komunale.

Në këtë frymë, Ekonomia e gjelbër është një nga pikat që neve na është kërkuar prej Bashkimit Europian që në masat dhe politikat tona të rimëkëmbjes të integrohen elementet e gjelbra si: energjia e pastër, mjedisi, biodiversiteti e financimi i qëndrueshmërisë. Kjo kërkesë ka ardhur

pikërisht në kohën kur ne po zhvillojnë procedurat fillestare të përgatitjes për Ankandin Publik për Energji të Ripërtrishme, me mbështetjen e Bankës Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim. Mirëpo, pasi ne kemi në domen edhe Ambientin, gjithsesi që ekonomia e gjelbër është në koherencë me projektet që synohen me anë të pjesës së Zhvillimit Ekonomik.

Në fushën e Minierave aktivitetet tona janë përqendruar në hartimin e Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale, zbatimin e Programit të Strategjisë Minerare 2018-2020, përkrahjen dhe krijimin e politikave për zhvillimin e ndërmarrjes Trepça.

Spektori i telekomunikimit dhe teknologjisë informative, është jashtëzakonisht i rëndësishëm për punësim dhe rritjen vlerës së eksportit të shërbimeve. Në kuptimin e zbatimit të Programit legjislativ, ne kemi planifikuar miratimin e Projektligjit për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, si dhe Projektligjin për Identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike.

Ne fushën e zhvillimit të aktiviteteve për ekonominë dixhitale, projekti për Krijimin e Qendrës për Ekselencë Dixhitale në Parkun për Inovacion dhe Trajnime në Prizren, parashihet të kompletohet me infrastrukturën e nevojshme. Poashtu, zbatimi i projektit për renovimin e ndërtesës së Qendrës për Ekselencë Dixhitale (QED) në ITP Prizren, Kompletimi i Parkut të Teknologjisë Dixhitale në Bërnice, i cili është dhënë në shfrytëzim të Shoqatës së Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimeve të Kosovës. Për më shumë, ju njoftoj që thirrjet për aplikim sipas skemës së granteve për Financimin e Infrastrukturës Dixhitale janë duke vazhduar.

Sfera e ndërmarrësisë dhe inovacionit është një nga shtyllat më të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat në Kosovë, me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë, si dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Andaj, në parashohim që Projektligji për Ndërmarrësi dhe Inovacion të miratohet sa më parë, duke krijuar në këtë mënyrë bazën ligjore në vend. Hartimi i Rregullores për mënyrën e funksionimit të Qendrave Rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, si dhe hartimi i Udhëzuesit për hartimin e pilot projekteve për "Qytetet e Mençura" në bashkëpunim me Kuvendet Komunale për komponentët e caktuara, do të realizohen sipas planit të Ministrisë. Si dhe në fund, ju njoftoj që ne jemi në përgatitje të mekanizmave për përkrahjen direkte financiare për Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Start-Up Bizneset (me fokus tek gratë dhe të rinjtë) me qëllim të zhvillimit të bizneseve dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Ju falënderoj për vëmendjen tuaj dhe mbetem i hapur për diskutime!

Avdullah Hoti: Faleminderit Zv. Ministër! Fjala për Zv. Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë.

Nexhat Ramadani:

Faleminderit Kryeministër! Të nderuar Ministra, kolegë, Zv. Ministra, të pranishëm të tjerë.

Unë sot do të fokusohem më shumë në atë që kemi bërë në zbatimin e planit për rimëkëmbjen e ekonomisë dhe punës që jemi duke bërë në MTI.

Pra, duke u bazuar në vendimin e qeverisë 01/23 të datës 13/08/2020 të *Planit për Zbatimin e Rimëkëmbjes Ekonomike*. Ne si ministri kemi filluar menjëherë punën, duke përgatitur udhëzimet dhe kriteret sektoriale për zbatimin e masave.

Konform këtij vendimi, në domenin e Ministrisë sonë bien disa masa. Në mesin e tyre masa I që ka për qëllim *Lehtësimin e Qasjes në Financim* dhe nënmasa 2 *Subvencionimi i Normave të Interesit* për sektor të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevant. Ne si ministri, në bazë të konsultimeve me shoqatat e bizneseve dhe informatave që kemi, duke pasur parasysh gjendjen që ka sjellur kriza e pandemisë Covid-19.

Sa i përket kësaj mase, kemi propozuar që të subvencionohen normat e interesit deri në 80% për të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat kanë kredi aktive dhe normave të interesit për kërkesa të reja për kredi deri në 80% të normës së interesit.

Sa i përket masës së 2-të që ka të bëjë me zvogëlimin e barrës tatimore, e konkretisht nënmasa B, *Mbulimi i 5% të Kontributit Pensional që biznesi paguan për punëtorët*, duke e ditur dëmin ekonomik të shkaktuar nga pandemia, vërehet se me ndalimin e pjeshëm të aktiviteteve prodhuese, përpunuese e shërbyese, fuqia blerëse ka pasur një rënie të dukshme. Andaj, duke u bazuar në këtë, ne kemi dalur me qëndrim që në këtë masë të subvencionohen sektorët e HoReCa, industria e shërbimeve, turizmi, transporti, ndërtimi dhe industria prodhuese dhe përpunuese ku hyjnë sektori i drurit, metalit, tekstilit dhe plastikës.

Sa i përket masës së 3-të, *Masat për Mbështetje të Punësimit*, konkretisht nënmasa C, që bie në domenin e Ministrisë sonë, e që ka të bëjë me përkrahjen profesionale për bizneset, për funksionimin në kushte pandemie siç është puna nga shtëpia, puna online dhe transformimi digjital. Përdorimi i shtuar i shërbimeve online gjatë pandemisë ka theksuar një pabarazi teknologjike dhe të rrjetëzimit, meqenëse jo të gjitha bizneset e sidomos ato të vogla dhe ato në zona rurale kanë pasur paisje të mjaftueshme për të kryer këto shërbime. Andaj, duke pasur parasysh të gjitha këto dhe me qëllim të ndihmës në këtë drejtim, ne kemi menduar që në kuadër të këtyre masave, të subvencionohen bizneset përmes paisjeve të vogla të cilat kontribuojnë në përmirësimin e produktit, siç janë: tabletët, pc apo paisje të tjera të ndryshme, pastaj shërbime të transformimit digjital, paisje që shërbejnë për përmirësimin e shërbimit e prodhimit, programe kompjuterike, software dhe sisteme kompjuterike, si dhe shërbime konsulente, trajnime të fuqisë punëtore për përdorimin e sistemeve teknologjike.

Nënmasa D, ka të bëjë me *Përkrahjen e Bizneseve Prodhuese dhe Shërbyese*, me paisje dhe makineri për automatizim të proceseve. Duke parë që kapacitetet prodhuese të ndërmarrjeve tona Kosovare, janë në nivel më të ulët se vendet e rajonit dhe në përgjithësi, ne kemi menduar se nevojë e rritjeve të kapaciteteve prodhuese të këtyre ndërmarrjeve është e një rëndësie të veçantë. Andaj, në kuadër të kësaj mase ku kemi të bëjmë me kapacitete prodhuese, kemi menduar që të subvencionohen me makineri prodhuese dhe përpunuese me teknologji të avancuara, paisje që përdoren për vlerësim të konformitetit, certifikim të produkteve të destinuara për eksport,

certifikim i produkteve të ndërtimit, standardizim të ndërmarrjeve dhe konsulencë për marketing, zhvillim të planeve të biznesit, menaxhim financiar dhe përmirësim të aftësive të punonjësëve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ndërsa sa i përket sektorit të shërbimit në Kosovë, në kuadër të kësaj nënmasë, në bazë të analizave që kemi bërë dhe të dhënave, shohim se tregtia e shërbimeve në Kosovë, në vitin 2020, në periudhën janar – maj, llogaritet në total 451,7 milion euro. Nga ajo eksporti i përgjithshëm është 324.1 milion euro, ndërsa gjithsej importi është 196.6 milion euro. Krahasuar me vitin 2019, për të njëjtën periudhë bilanci tregtisë së shërbimeve në total ka pasur një rënie prej 49%.

Andaj konform kësaj gjendje, në kuadër të këtyre nënmasave kemi menduar që këto ndërmarrje të shërbimeve të subvencionohen me sisteme software, konsulencë për marketing, zhvillim të planeve të biznesit, menaxhim financiar dhe përmirësim të aftësive të punonjësëve të ndërmarrjeve, përkrahje në rrjetëzim dhe krijim të zingjirit të vlerës, certifikim të shërbimeve dhe standardizim të ndërmarrjeve shërbyese.

Nënmasa C, përkrahja e bizneseve me qëllim të rritjes së produktivitetit, në bazë të analizave kemi rënie në përfundim se këto ndërmarrje, sa i përket rritjes së produktivitetit, duhet të subvencionohen në plotësimin e linjave prodhuese, teknologji dhe inovacion, zhvillimin e infrastrukturës fizike, përfshirë edhe transportin efikas, energjinë, rrjetet telekomunikuese, adaptim i mënyrës organizative, përmirësimi i zingjirit të furnizimit, hulumtimi dhe zhvillimi.

Këto janë ato që kemi filluar pas vendimit të qeverisë dhe ne jemi duke vazhduar edhe pjesën tjetër që ka të bëjë me krijimin apo përgatitjen e kriterëve për vlerësim të kompanive që do të përfitojnë nga këto masa.

Ju Faleminderit!

Besian Mustafa:

Faleminderit Kryeministër! Të nderuar Kryeministër, Zv. Kryeministër, Zv. Ministra, Guvernatorë dhe mbi të gjitha, përfaqësues të sektorit privat.

Po mundohem të jem shumë i shkurtër duke u fokusuar në kërkesën e kryeministrit që të kemi diskutim më të gjerë në programin e rimëkëmbjes ekonomike.

Ashtu siç tha edhe Kryeministri, kemi të ndara 24 milion euro për dyfishim të buxhetit për subvencione për vitin 2020. Me 25 gusht, pra të martën e ardhshme, do të kemi një takim me shoqatat e sektorit për të diskutuar draft kriteret, që të kemi një draft final të kriterëve i cili është i filtruar dhe i aprovuar edhe nga vet sektori. Kemi një mori shoqatash, siç e dimë të gjithë, sektori i bujqësisë ka një zingjirë të vlerave mjaft kompleks, prandaj edhe është një insistim i imi personal por edhe zotim i kryeministrit që të kemi një diskutim të hapur me tërë zingjirin e vlerave dhe përfaqësuesit e hallkave të këtij zingjiri, që të kemi kriterë që në fakt përfaqësojnë nevojat për rimëkëmbje ekonomike të sektorit.

Pra, nuk është ideja që të kemi një dyfishim me automatizëm të të gjitha subvencioneve, por që të kemi një dyfishim të buxhetit, e brenda këtij buxheti të dyfishuar të kemi një targetim të nevojave për rimëkëmbje ekonomike të sektorit të bujqësisë. Njëkohësisht kemi të ndara edhe 2 milionë euro për subvencionimin e interesit të agrokredive, këtu shfrytëzoj rastin të falenderoj Bankën Qëndrore për përkrahjen fillimisht me ndarjen e informacioneve, por edhe në përpilimin e kriterëve dhe në draftimin e një strategjie, se si do përcaktojmë ose përzgjedhim se ku do i përqëndrojmë këto 2 milion euro për subvencionimin e interesit të agrokredive.

Fare në fund Kryeministër, të nderuar të pranishëm, dua vetëm të ju informoj, siç ju kam informuar edhe në takimin e fundit, që tanimë vetëm kemi filluar me përpilimin e programit për bujqësi dhe zhvillim rural, pra ajo që njihet si programi i granteve, për 7 vitet e ardhshme, 2021-2027.

Kemi bërë përpilimin e grupeve punuese dhe së shpejti fillojmë edhe konsultimet me përfaqësuesit e sektorit privat duke filluar nga niveli i shoqatave të hallkave të zingjirit të vlerave në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, pastaj duke vazhduar edhe me përfaqësuesit e odave ekonomike që të kemi një orientim strategjik, një vizion strategjik për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural për 7 vitet e ardhshme. Pastaj, këto përkthehen në programe konkrete vjeçare, pra 7 programe vjeçare. Mirëpo, do bëjmë një përpilim të strategjisë 7 vjeçare për bujqësi dhe zhvillim rural, me kërkesën dhe vullnetin e kryeministrit, duke ekzekutuar këtë kërkesë dhe vullnet Ministria e Bujqësisë, që të kemi një diskutim dhe koordinim transparent me përfaqësues të sektorit privat në përgjithësi dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në veçanti.

Kryeministër dhe të pranishëm, ju falenderoj!

Avdullah Hoti: Faleminderit shumë Ministër!

Me lejen e juaj, unë propozoj të bëjmë një ndryshim në agjendë, besoj edhe znj. Daija dakordohet për këtë. Kemi prezent edhe Zv. Ministrin e Arsimit dhe në emër të Ministrit Abrashi, z. Kllokoqi, nuk i kemi paraparë në agjendë, mirëpo nëse e shohin të nevojshme gjatë diskutimit, mund të inkuadrohen kurdo në emër të ministrive përkatëse.

Propozoj që t'a zhvendosim pikën e diskutimit të znj. Daija, duke qenë pra se do të na tregojë për mbështetjen që do të japë Sekretariati ndaj këtij Këshilli në zbatimin e pakos për rimëkëmbje ekonomike dhe i kemi disa çështje që janë procedurale dhe rregulloren e punës së këshillit e të tjera, do t'i vendosnim në fund, me dakordimin tuaj.

Unë lus Zv. Kryeministrin dhe Ministrin e Pushtetit Lokal të marrë fjalën shkurt, dhe pastaj po e hapim diskutimin menjëherë me përfaqësuesit e odave ekonomike sipas agjendës.

Goran Rakic:

Faleminderit Kryeministër! I nderuar Kryeministër, Ministra, të nderuar mysafirë.

Edhe Ministria e Pushtetit Lokal e ka fondin prej 10 milion euro, dhe të hënën, Kryeministri dhe unë kemi takim me kryetarët e komunave. Fondi është direkt për të shtyer përpara, komunat dhe qytetarët, për të ndihmuar zhvillimin e ekonomisë, dhe për të luftuar Covid-19.

Unë vetëm shkurt po flas sot. Faleminderit Kryeministër!

Të hënën kemi takim me kryetarët e komunave dhe jemi direkt në kontakt me këta, do t'i dëgjojmë se çfarë mbështetje u nevojitet atyre. Para së gjithash falenderojmë qeverinë, kryeministrin i cili ka përfitu ato mjete, ngase kryetarët e komunave më së miri e dinë, cilat janë nevojat e komunave të tyre, s'mundemi që t'i çasemi të gjitha nevojave të secilës komunë, në të njëjtën mënyrë. Ne do jemi këtu, si ndihmë e drejtpërdrejtë, para së gjithash për qytetarët që jetojnë nëpër ato komuna.

Nëse keni ndonjë pyetje, jam në dispozicionin tuaj.

Avdullah Hoti: Faleminderit Zv. Kryeministër! Atëherë po fillojmë me diskutimet. E lus z. Berat Rukiqi nga Oda Ekonomike e Kosoves të marrë fjalën.

Berat Rukiqi:

Së pari na vije mirë që u kthyet në angazhimet e juaja shëndetshëm dhe e kaluat një sfidë shëndetësore!

Dëshiroj të përshëndes të gjithë ministrat, të gjithë drejtorët e agjencive dhe shoqatave të ndryshme.

Është mirë që po rikthehemi të diskutojmë në këtë format, me një emër të ri, e që sigurisht adreson edhe ndryshimet në përgjithësi edhe të përmbajtjes së temave dhe normalisht edhe të asaj çfarë na pret në të ardhmen.

Fokusi im është në dy pjesë, pjesa parë ka të bëjë pakon tashmë të miratuar të rimëkëmbjes. Shumë me rëndësi është të theksohet që efikasiteti, jo vlera e përcakton edhe suksesin e pakos. Pra, si ta sigurojmë këtë efikasitet e mos ta kemi situatën e njëjtë siç e kemi pasur me pjesën e emergjencës.

Dhe këtu para së gjithash, vjen edhe roli i Parlamentit. Ne edhe në të kaluarën edhe tash, vetë ofrohemi të përkrahim edhe ngritjen e vetëdijes edhe të vëmendjes brenda deputetëve, grupeve të ndryshme parlamentare, në mënyrë që kjo pako të votohet sa më shpejtë, sepse ne besojmë që rimëkëmbja ekonomike është kauzë nacionale e nuk është kauzë as e qeverisë e as e grupeve të ndryshme të interesit, por është një kauzë nacionale dhe duhet të gjithë t'a kuptojnë si të tillë. Dhe ne besojmë që fillimi i muajit shtator do ta shënojë edhe miratimin e ligjit për rimëkëmbjen ekonomike.

Kjo ka rëndësi për një dimension që për ne është shumë i rëndësishëm, nga aspekti psikologjik, pa dashur t'a trajtoj si psikolog sepse nuk jam i atij profesioni. Mirëpo, nga aspekti ekonomik ka shumë rëndësi që muaji shtator dhe tetor të shënojnë hyrje të mjeteve të reja në qarkullim, për

shkak se kjo do të ndikojë drejtpërdrejtë në konfidencën edhe të bizneseve edhe të konsumatorit. Kjo ngritje e konfidencës, përkthehet në rritje të optimizmit dhe rritja optimizmit pastaj mund të përkthehet në rritje të fuqisë blerëse, të ndryshimit të sjelljes së konsumatorit, i cili sot është pak më konservativ në kuptim të shpenzimeve. Në të njëjtën kohë, e kthen një energji tjetër, një dinamikë tjetër të biznesit që mund të vazhdojë pastaj me investimet e veta dhe me ruajtjen edhe të aktivitetit ekonomik, por edhe të vendeve të punës të cilat më shumë vështirësi i kanë krijuar. Prandaj, unë besoj që muaji shtator dhe muaji tetor, janë muajt kyç sa i përket këtyre masave afatshkurta që lidhen me rimëkëmbjen ekonomike.

Tek masat tjera, unë ende nuk kam arritur t'i kuptoj dhe ndoshta është mirë t'a diskutojmë këtë pjesën se pse duhet të paguhet një "fee" (tarifë) për fondin për garanci kreditore. Më mirë është ato mjete të shkojnë në ekonomi drejtpërdrejtë se sa të paguhet administrimi nga ana e fondit për garanci kreditore. Më është dukur e tepërt, d.m.th. me mjetet e buxhetit të paguhet puna e fondit për garanci kreditore.

Një sektor ose më mirë të themi dy sektorë që duhet të shihen më me kujdes tek pjesa e rimëkëmbjes është turizmi. Sot është e vështirë t'i shohësh p.sh. një pjesë të madhe të hoteleve, të investimeve që kanë ndodhur, që nuk e kanë asnjë mysafir. Nuk e kanë pothuajse asnjë qarkullim. Vendet e tjera kanë shkuar me stimulime të drejtpërdrejta, të përdorimit të shërbimeve të hotelerisë dhe gastronomisë përmes mjeteve të ndryshme buxhetore, siç ka qenë skema e vouchereve në Maqedoni, Shqipëri dhe vende të tjera. Ndoshta është mirë t'a mendojmë këtë lloj skeme, nëse jo me buxhet të këtij viti, së paku me buxhet të vitit që vjen.

Sa i përket asaj kërkesës për 8% në HoReCa apo gastronomi, që parashihet si normë e diferencuar e TVSH-së, ne ju falenderojmë që e keni përfshirë në radhë të parë, mirëpo në pjesën tjetër ne kërkojmë që kjo të mos jetë e afatizuar në bazë të afatit ligjor të ligjit për rimëkëmbjen ekonomike, por kjo të vazhdojë, sepse ka nevojë të jetë e tillë edhe për vitet në vijim.

Ne po shohim shumë probleme në gastronomi dhe këta sektor që janë të prekur drejtpërdrejtë nga masat kufizuese ku në periudhën afatmesme, problemin kryesor do t'a kemi te sektori i ndërtimit që prekë shumë sektorë dhe nënsektorë tjerë dhe duhet parë me kujdes se si mund t'a nxisim kërkesën dhe si mund të e fasilitojmë operimin e këtij sektori në vitet në vijim. Për shkak se çfarëdo bllokade apo problemi në këtë sektor na percjell me efekte zingjirore në shumë sektorë të tjerë.

Pjesa tjetër besoj që do të vazhdojë edhe Ariani, për shkak se kemi përgatitur një dokument që do t'i dorëzohet këshillit dhe kryeministrit. Ka të bëjë me mundësinë që të shfrytëzohet rimëkëmbja edhe për transformim të ekonomisë. Shumë me të drejtë e tha kryeministri, nuk jemi duke folur për një periudhë 2020-2021, kur jemi brenda pandemisë, por jemi duke folur për një periudhë afatgjatë. Ne kemi humbur dy mundësi për transformim të ekonomisë, pas luftës dhe e kemi humbur mundësinë në vitin 2008, nuk bënë ta humbim tash këtë mundësi. D.m.th. duhet t'a shohim si një mundësi që na ofron në një ekonomi të qëndrueshme dhe para së gjithash le të jetë me fokus te eksporti dhe investimet, sidomos duke ditur ndryshimet që po ndodhin globalisht në zingjirët e furnizimit. Edhe fokusi i tërheqjes së investimeve të huaja direkte duhet me qenë aty, edhe fokusi i rritjes së eksportit duhet me qenë aty. Edhe masat e rimëkëmbjes duhet me qenë të ndërlidhura me këto kritere. Pra, sa mundemi me i ndihmu kompanive të integrohen në zingjirët

globale dhe rajonale të furnizimit dhe sa mundemi të nxisim investime të huaja direkte në këtë drejtim.

Projektet infrastrukturore, nuk ka nevojë ndoshta me elaboru unë këtë pjesë mirëpo është shumë me rëndësi që të kemi lidhje hekurudhore edhe rrugore edhe me Maqedoninë edhe me Malin e Zi edhe me Shqipërinë. I japim vetes një avantazh të jashtëzakonshëm strategjik për shkak se do të kemi çasje në 4 porte të rëndësishme ndërkombëtare; në Selanik, në Durrës, në Bari dhe në Stamboll që nuk e ka pothuajse asnjë vend i rajonit. Dhe normalisht i ndihmojmë ekonomisë këtu brenda.

Energjia, ne ende nuk e kemi të qartë se si do të duket modeli jonë sa i përket energjisë. Kosova nuk e ka të garantuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe kjo është shumë me interes edhe për investitorët por edhe për vendin në përgjithësi, edhe për sigurinë kombëtare besoj në veçanti.

Dhe e fundit, tek transformimi, edukimi.

Ekonomia po transformohet edhe këtu, po transformohet edhe globalisht, ne duhet të krijojmë programe që i adresojnë këto profesione të reja që mund të krijohen edhe tash si rezultat i ndryshimeve që i ka sjellë pandemia apo si rezultat i asaj që po futemi në normalitetin e ri.

Sigurisht, Ariani e vazhdon elaborimin e propozimeve që i kemi në këtë pjesë, mirëpo unë po e mbylli me kaq dhe po ju falenderoj për vëmendjen! Ne jemi të hapur si gjithmonë për të diskutuar tema edhe tjera që duhet të trajtohen nga këshilli. Unë e kam vetëm një pyetje, është jashtë pjesës së rimëkëmbjes por ndoshta është mirë pasi është prezenca e Kryeministrit dhe zv. Ministrit të Financave. Komisioni Parlamentar e ka refuzuar kalendarin e akcizave, për shkak që të krijohet një parashikueshmeri në treg, neve na duhet edhe t'i japim një përgjigje industrisë, pra si do të jetë prej 1 shtatorit, a do të jetë sipas vendimit të qeverisë apo ka ndonjë qëndrim tjetër apo vendim tjetër që vjen si pasojë e refuzimit të vendimit të qeverisë nga ana e Komisionit Parlamentar. Nga sa e di unë, nuk është obligativ mendimi i komisionit parlamentar por megjithatë, sigurisht kryeministri mund të na sqaroj më mirë.

Faleminderit!

Arian Zeka: Faleminderit shumë Kryeministër! I nderuar Kryeministër, zv Kryeministër, zv Ministra, kolegë nga asociaconet e biznesit, institucionet financiare ndërkombëtare, zonja dhe zotërinjë.

Ashtu siç e paralajmëroi z. Rukiqi, ne kemi një dokument të përbashkët, një version të azhurnuar të cilin do t'a dorëzojmë pas këtij takimi edhe pse pikat kryesore tashmë i janë dorëzuar sekretariatit të KKEI të cilin po ashtu e përgëzoj për punën e mirë që kanë bërë gjatë gjithë kësaj kohe. Ky dokument që kemi para nesh, që përmban rekomandimet e asocioneve të biznesit në disa faza prej shpërthimit të pandemisë e tutje, besoj që është dëshmia më e mirë dhe në të njëjtën kohë është edhe një material i mirë për të gjitha vendimet që qeveria do ti marrë në ditët në vijim.

Para se të elaboroj pikat e këtij dokumenti të përbashkët, më lejoni që të ngrej një çështje tjetër e cila nuk është në agjendë, megjithatë është një gjë që është me prioritet të madh. I kam përcjellur Kryeministrit një shkresë që ka të bëjë me rregullimin e çështjes së lëvizjes së lirë të punëtorëve pas orës 22:30, diçka që nuk po gjejmë zgjidhje. E kemi adresuar edhe tek zyrja e Kryeministrit, na është thënë që është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përgjegjëse për këtë. I kemi përcjellur shkresë Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, ai na ka thënë që një vendim i datës 9 korrik i jep zgjidhje kësaj çështje, në ndërkohë edhe policia dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike e thotë të njëjtën gjë. Ne kemi pasur takim edhe me drejtorinë e përgjithshme të Policisë së Kosovës ku na është thënë që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet të lëshojë një vendim të ri ku sqarohet që meqenëse pikat e shitjes dhe organizatat e biznesit lejohen të punojnë deri në orën 22:30, atëherë është e vetëkuptueshme që do të nevojitet një kohë e caktuar për punonjësit të udhëtojnë deri në shtëpitë e tyre dhe në vendbanimet e tyre. Gjatë javëve të kaluara kemi pasur raste kur punonjësit janë ndalur dhe janë bërë fletëparaqitje ndaj tyre, janë marrë dhe janë dërguar nëpër stacione të policisë, edhe përtej malltretimit nëse mund ta quaj ashtu, aty për aty, problem i punëdhënësve është kjo pastaj e lënë të hapur një lloj historiku penal ose kundërvajtjeje për punonjësit dhe kjo është pjesa më e dhimbshme që i lus edhe njëherë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe ju kërkoj të gjithëve falje që dola prej agjendës pa marrë leje paraprake.

Sërish për të ndikuar në rritjen e konsumit në ndërmarrjet e këtij sektori kemi propozuar uljen e TVSH-së për pijet joalkoolike në 8%, diçka që nuk është thënë deri më tani, pra kjo edhe te kompanitë të cilat ofrojnë mallra ose produkte të sektorit HORECA.

Edhe diçka që është me rëndësi po ashtu nuk është trajtuar gjatë kësaj periudhe është edhe mundësia e programimit të detyrimeve tatimore për të gjitha bizneset, detyrime të cilat janë krijuar pas shpërthimit të pandemisë. Pra, jo falje e gjobave dhe interesave ashtu siç është propozuar e që tashmë është përfshirë në projektligjin për rimëkëmbje ekonomike, por programimin e detyrimeve tatimore për një periudhë 24 mujore, nga data e vendosjes së masave të para kufizuese pas shpërthimit të pandemisë.

Dokumentet janë dorëzuar me shkrim dhe këtu po e ndërprej, kështu që ju faleminderit të gjithëve për vëmendjen!

Besoj që fokusi ditëve në vijim, përveç njëfarë presioni me konstruktiv tani mbi deputetët e kuvendit që t'a aprovojnë menjëherë pas kthimit nga pushimi projektligjin për rimëkëmbje ekonomike. Pastaj është edhe ulja e diskutimi i përbashkët i yni me ju në percaktimin e kriterëve se si do të bëhet shpërndarja e mjeteve në të gjitha masat përkatëse nga programi i rimëkëmbjes.

Ju faleminderit edhe njëherë për vëmendjen!

Avdullah Hoti: Faleminderit Z. Zeka. Tash e lus Z. Astrit Panxha nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës.

Astrit Panxha: Përshëndetje të gjithëve, Z. Kryeministër ju urojmë mirëseardhje në detyrë prap, pas tejkalimit të Covidit. Të nderuar ministra, të nderuar kolegë të organizatave, të nderuar pjesëmarrës, ne do t'i diskutojmë dy pika shkurtimisht si çështje që i kemi ngritë në të kaluarën dhe i kemi dorëzuar në institucionet përkatëse. Çështja e parë ka të bëjë me ndryshimin e ligjit të prokurimit publik. Duhet të kemi parasysh që me rishikimin e buxhetit kemi rritje në shpenzimet kapitale dhe është pjesa tjetër e blerjes së mallrave dhe shërbimeve nga qeveria. Ne kemi shikuar dhe analizuar në vazhdimësi vendet e rajonit dhe vendet tjera se si po i qasen blerjeve publike në ekonomi. Bosnja dhe Hercegovina me një vendim qeveritar, ka miratuar një udhëzim shtesë, ku i jep 20% përparësi kompanive prodhuese dhe shërbyese vendore me rastin e aplikimit në tenderë publikë. Edhe pse Bosnja dhe Hercegovina është nënshkruese e MSA-së dhe është më e avancuar në integrimet Evropiane se sa Kosova, ka marr këtë vendim jo të përhershëm, por për një periudhë dy vjeçare. Për ne do të jetë shumë me rëndësi në qoftë se edhe ne bëjmë një gjë të tillë, duke marrë parasysh që injektimi i 700 milionë euro-ve investime kapitale, në qoftë se ndodhë përmes stimulimit të rritjes së prodhimit, atëherë efekti në ekonomi do të jetë shumëfish më i madh. Ne jemi për ekonomi të lirë, por duke marrë parasysh se shumë vende (edhe të BE-së) në këtë kohë janë duke ndërmarrë masa jokonvencionale për stimulimin e ekonomisë dhe mos të kemi rënje të mëtutjeshme—për ne është shumë me rëndësi që të ndërmarim hapa të tillë. Këto janë paratë e taksapaguesve të Kosovës; mund të vendosim një periudhë 2 vjeçare ku prap do të kthehet ligji në formën ekzistuese. Edhe me MSA-në e kemi pasur të nënshkruar për një periudhë 5 vjeçare ku gradualisht kemi qenë të obliguar të ulim përparësinë që kanë pasur operatorët ekonomik vendorë, por për fat të keq ne në ligj e kemi pasur edhe operatorë jo-prodhues apo shërbyes vendorë—kështu që ka nënkuptuar edhe nga jashtë që kanë hapur degë në Kosovë dhe kanë përfituar tendere me produkte të importit. Prap po them, në qoftë se vendoset të ndërtohen rrugë të reja apo banesa sociale nga Qeveria—të kenë përparësi prodhuesit dhe shërbyesit vendorë apo të ndërrohet një softëare në një nga Ministrinë, atëherë ne kemi kapacitete të mjaftueshme në sektorin e teknologjisë informative që kjo të bëhet me resurse të brendshme. Besoj që do të hasim në mirëkuptim edhe nga Komisioni Evropian dhe nga Institucionet tjera, për arsye se ne po përballemi me një vështirësi të madhe ekonomike. Mos të harrojmë që qershori, korriku, gushti janë tre muajt e vitit ku shumë nga prodhuesit kanë gjeneruar të hyra për shkak të rritjes së turizmit dhe diasporës dhe me këto tre muajt e kanë mundur edhe pjesën tjetër të vitit dhe kanë qenë determinuese se a do të kemi investime, rritje, apo stagnim vitin e ardhshëm. Ne pasojat do t'i shohim tek në muajin tetor dhe nëntor, ku edhe kompanitë mund të hasin në vështirësi. Në qoftë se kjo kompenzohet me investimet qeveritare, ne mund ta tejkalojmë këtë krizë. Një pikë që do të prekë shumë shkurtë është subvencionimi i eksportit; ne edhe në të kaluarën e kemi paraqitur si kërkesë largimin e tatimit në fitim në eksport. Mos të harrojmë që eksportet tona sillen në rreth 400 milion euro dhe implikimet buxhetore nuk janë të mëdha në qoftë se kompanive ju largojmë këtë barrë shtesë që e kanë. Jam optimist që këto kursime që do t'i kenë kompanitë prodhuese nga ky tatim në fitim do të reflektohen në ulje të

çmimit të produkteve, të cilat i bën më konkurruese në tregjet e rajonit—apo këto mjete mund të riinvestohen në kapacitete shtesë të prodhimit. Implikimet buxhetore, të jemi të sinqertë, e dimë që ne e kemi një buxhet të limituar në këtë fazë dhe kur e rishikojmë me rishikimin e buxhetit, të hyrat do të jenë substancialisht më të ulëta se që janë parashikuar. Ne duhet të jemi të sinqertë për mundësitë, mirëpo implikimet në eksport do të kthehen shumëfish në buxhetin në periudhë afatgjatë.

Këto ishin dy pikat, dhe isha referu tek pyetja e Beratit sa i përket akcizës, po ashtu edhe ne jemi shumë të interesuar në çfarë faze kemi mbetur, sepse ka qenë kërkesë e jona e vazhdueshme që akciza në lëngje të hiqet. Sipas ligjit, Ministria e Financave ka qenë e obliguar vetëm të konfirmon komisionin, mirëpo në çfarë faze jemi duhet të dimë sepse edhe prodhuesit e lëngjeve janë duke pritur se si të procedojnë në këtë aspekt.

Avdullah Hoti: Faleminderit z. Panxha. Z. Shahini, kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve.

Agim Shahini: Faleminderit i nderuari z. Kryeministër, Ministra, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare

Aleanca Kosovare e Biznesit e ka mbështetur masën 15 të Qeverisë së Kosovës, ku janë përfshirë pothuasje të gjitha kërkesat e bizneseve në mënyrë direkte dhe indirekte. Ne kërkojmë që të implementohen ato 15 masa dhe në implementimin e tyre në çfarëdo kohe, ne si AKB mund të jemi partnerë. E dimë se çdo ditë ka kërkesa të reja, por duhet ta kuptojmë se çdo ditë kemi edhe vështirësi të reja, prandaj konform vështirësive duhet të jenë edhe kërkesat çfarëdo qofshin ato. Para se të kalojë në pikat të cilat do referohem, nëse ndalem tek ligji për prokurim publik, AKB ka ngritë këtë çështje në vitin 2011 dhe komisioni Evropian nuk e ka lejuar që produkteve vendore t'u jepet përparësi me një përqindje. Atëherë, kemi kërkuar rreth 10-15%, për shkak se e humb fuqinë e tenderit ndërkombëtar me përparësi dikujt tjetër. Kemi bërë analizat atëherë dhe ato analiza ekzistojnë edhe në qeveri edhe tek ne. Sa i përket akcizës së lëngjeve, komisioni dhe disa deputete kanë qenë të painformuar, ekziston tek ne një analizë e thuktë në këtë drejtim se çfarë efekti ka dhe deputetet nuk e kanë kuptuar ose kanë kuptuar jo drejtë efektin e akcizës, prandaj ne si AKB kërkojmë që më tutje të shtyhet ky proces në të mirë të gjithë akterëve kyç në këtë vend.

Sa i përket pikave sipas agjendës, ne kemi tentuar të prekim dy pika që nuk janë të parapara në këtë çështje, kurse për faljen e borxheve është e paraparë edhe me masa. Nëse ndalemi në pikën para se të shkojmë tek paga minimale; pse duhet të falen borxhet. Ne kemi analizuar një hulumtim i cili ende nuk është publikuar dhe ky hulumtim ka të bëjë me 835 biznese që ka të bëjë edhe me pagën minimale edhe akciza të ndryshme, qoftë edhe me pagën mesatare apo edhe investimet e huaja. Në bazë të saj bizneset kanë rekomanduar që nëse falen borxhet duhet të falen edhe ndëshkimet, për shkak të humbjes së fuqisë juridike për shkak të krizës së pandemisë. Bizneset, nëse nuk kanë mbështetje drejtpërsëdrejti, mund të kenë mbështetje nëse falen ndëshkimet pavarësisht për cilën periudhë ka mundësi me u falë. Bizneset dhe qytetarët lirohen nga barra dhe stresi i borxhit, është kjo shumë e rëndësishme. Edhe në vitin 2015 Qeveria ka

marr një vendim ku fali një pjesë të borxheve dhe nga ato borxhe pothuajse kanë përfituar të gjithë, kurse shteti në këtë rast do të solidarizohet me ata të cilën nuk kanë pasur mundësi t'i paguajnë me kohë. Dikush mund të thotë: “Une i kam paguar me kohë, pse të ia falim tash dikujt?” dhe unë mendoj që atij që i është falur të ketë një shenjë që së paku 3 vitet e ardhshme kompania/individit të mos ketë të drejtë të konkurojë në tendera publik, në mënyrë që ata të kenë një ndëshkim më vonë. Mendoj që këtë e kanë bërë shumë shtete. Në këtë kohë të pandemisë ATK-ja ka bllokuar shumë biznese të cilat kanë borxhe dhe kanë obligime. Mendoj që ndoshta kishte qenë mirë që ATK-ja të lirojë bizneset nga bllokatat në llogaritë e tyre, në mënyrë që t'u jepet mundësi sepse nuk kanë nga të shkojnë. Pakoja prej 180 milion EU nuk i ka përfshirë të gjitha bizneset. Kurse pandemia i ka prekur më shumë se 85% të bizneseve, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte.

Sa i përket pagës minimale, i nderuar Kryeministër, AKB-ja flet edhe për cilësinë dhe rekomandimet e Këshillit Ekonomik Social si anëtarë që jemi. Paga minimale në Kosovë është 170 euro dhe gjatë kohës së pandemisë pagat e punëtorëve u paguan pjesërisht 170 euro si bazë dhe të gjithë punëtorët e sektorit privat kanë qenë të pakënaqur me këtë vlerë, sepse ka qenë e vogël. Atëherë, ne duhet të ecim përpara dhe në bazë të studimit tonë Kosova qëndron më së keqi me pagë minimale; ku Kosova e ka 170 euro, Shqipëria e ka 211 euro, Mali i Zi e ka 288 euro, Maqedonia e ka 240 euro, Serbia e ka 308 euro, është përmendur Bosnia (të cilën nuk kemi nevojë ta marrim si pikë referuese për asgjë) që e ka 225 euro, Kroacia e ka 506 euro, Bullgaria e ka 235 euro, Greqia e ka 684 euro.

Sa i përket rritjes së pagës minimale, me z. Agimin kemi punuar në këtë drejtim shumë dhe jemi pajtuar që janë 4 kritere bazë ne bazë të nenit 57 të Ligjit të Punës. Ato janë:

1. Kostoja e shpenzimeve jetësore;
2. Përqindja e shkallës së papunësisë;
3. Gjendja e përgjithshme e tregut të punës;
4. Shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend.

Këshilli Ekonomik Social e ka hapur këtë pikë në një takim, ku jemi pajtuar për ngritjen e pagës, por Qeveria më vonë e ka refuzuar ngritjen e pagës minimale. Edhe pse, kur flas për rritjen e pagës minimale, nuk flas shumë në favor të bizneseve por më shumë në favor të punëtorëve. Pavarësisht, ata edhe ne jemi punëtorë të dikujt dhe në asnjë formë nuk duhet të jemi “ne” ose “ata”, por duhet të jemi “bashkë”. U pa se gjatë pandemisë 170 euro ishin pak dhe çështjet që mund të lëvizim përpara në të mirë të vendit kjo Qeveri nuk ka pengesa për ti shtyer. Unë mendoj se kjo Qeveri ka dallim shumë të madh me ato në të kaluarën për shkak se krerin e Qeverisë e shohim si një reformator ekonomik dhe një njeri që mund të bëjë të mundur përtej pengesave, përderisa e dimë se ku qëndron problemi. Ne i kemi kritikuar ashpër deputetët e vendit për rishikim të buxhetit, për mos-ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare, programin qeverisës, sepse ne nuk po e dimë kujt mund t'i pengonte programi për rimëkëmbje ekonomike. Të gjithë jemi në krizë dhe dalim të kritikojmë e të flasim, por aty ku duhet të ngrisin dorën

deputetët nuk po e ngrisin. Aty janë 120 vende në Parlamentin e Kosovës, kurse marrin pjesë vetëm 50, 60 apo 6, ndërsa pagat i marrin të gjithë me kohë. Ndërkaq, sektori privat ka vështirësi në paga. Hulumtimi, i cili ka qenë në të gjithë Kosovën, ka identifikuar që mbi 85% të ndërmarrësve kanë vështirësi të paguajnë pagat, kurse 100% të punëtorëve të organizatave buxhetore publike nuk kanë vështirësi, e ne varemi nga ata qoftë për ngritjen e dorës apo vendime të ndryshme. Unë mendoj që insitucionet publike, shtetërore duhet të jenë më azhur dhe të japin përgjegjësi më shumë. Faleminderit Kryeministër.

Avdullah Hoti: Faleminderit z. Shahini. E lus tash z. Emrush Ujkani ose atë që e përfaqëson.

Ardian Shehu: I nderuar Kryeministër, të nderuar ministra të qeverisë së Kosovës, të nderuar përfaqësues të odave e shoqatave të biznesit.

Në Keshillin e Investitorëve Evropian kemi pasur disa takime në forma të ndryshme me anëtarët tanë për tu konsultuar se cilat do ishin format e reagimit në një situatë të krijuar. Pandemia me siguri që ka ndikuar në zvoglimin e aktivitetit ekonomik, çka ka ndikuar në gjithë sektorët ekonomik e me këtë edhe në mirëqenien e qytetarëve tanë. Kjo situatë duket tashmë nuk është afatshkurtë dhe duhet të jemi të vetëdijshëm e të përgjegjshëm për masa dhe planifikim po ashtu jo afatshkurtër.

Duke u munduar te diskutojmë dhe të identifikojmë forma se si të minimizohet ndikimi negativ në aktivitetin ekonomik e në raste të caktuara si të rritet, ne kemi identifikuar se përkrahja e zgjedhjeve digjitale (digital solutions) në sektorë të ndryshëm mund të ndihmojë në mbarëvajtjen e aktivitetit ekonomik dhe diku edhe rritjen e tij.

Për “zgjedhjet digjitale” gjindet një definicion ku thuhet se zgjedhjet digjitale është një zgejdhje që mundëson përdorimin e teknologjive digjitale për të rritur një aktivitet ekzistues biznesi ose për të kryer aktivitete të reja biznesi ... ky definicion në kohën e nevojës për distancim social zgjrohet në kuptimin që zgjedhja digjitale është edhe domosdoshmëri për kryerjen e aktivitetit ekonomik, ndoshta edhe mënyrë e vetme.

Ne kemi identifikuar dhe ju kemi dorëzuar një gjetje të shkurtë për zgjedhjet digjitale në përdorim në Kosovë, disa që i kemi numëruar, por edhe kemi identifikuar disa akcione që mund të ndërmerren nga qeveria dhe akterët tjerë të interesuar në Kosovë (donatorë të huaj, agjencione për zhvillim, etj)

- Përkrahja e shitjes “online”: kemi elaboruar se si mund të ndihmohen kompanitë e vogla që të implementojnë sistemet e pagesave elektronike, çfarë është infrastruktura ekzistuese dhe cilat janë sfidat. Këto janë investime jo të mëdha, por mund të jenë të papërbalueshme prej operatorëve ekonomik dhe ndoshta jovisibile;
- Përkrahja e kompanive për liferim: postave me investimet në sistemet e tyre për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, por po ashtu edhe për të rregulluar sistemin e pagesave. Jemi të bindur që një përkrahje e tillë do të ndihmonte edhe formalizimin më të madh të

këtij aktiviteti ekonomik dhe te aktivitetit të shitblerjes online në përgjithësi, që indirekt do të shpaguej me rritjen e të hyrave buxhetore;

- Aprovimi sa më i shpejtë i "Ligji për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e bazuara në Transaksione Elektronike" i cili është në përputhje me Rregulloren e BE-së Nr. 910/2014 që njihet si eIDAS (Shërbimet e Identifikimit Elektronik, Verifikimit dhe Besimit). Te rëndësia e aprovimit të këtij ligji do isha ndalur pak me gjatë, duke pasë parasysh se mendojmë se duhet të ekzistoj një vullnet më i madh politik që kjo të shtyhet më shpejtë. Për këtë isha ndalë në shpjegim më të saktë se për çka ky ligj hap dyert, për ju por edhe për opinion që na përcjell. Ky ligj definon nënshkrimin e certifikuar elektronik dhe si bëhet ai i njohur si QES. Nënshkrimi i certifikuar elektronik është i barazvlefshëm në çdo kohë dhe para secilit institucion me prezencën dhe nënshkrimin fizik. Kjo është e domosdoshme që shumë aktivitete të cilat sot janë të pamundura të bëhen pa prezencë fizike, të kryhen në distancë, psh nënshkrimi i kontratave para noterit, hapja e llogarisë në bankë, nënshkrimi i kolateralit për kredi, kërkesa, padi, vendime, vërtetime, të cilat janë të definuara me ligj ose me rregullore që duhet nënshkrim dhe prezencë fizike... p.sh. kërkesa në gjykatë për vërtetim që nuk je i dënuar. Çka është QES dhe Autoriteti Certifikues kemi sqaruar shkurt në dokumentin e dorëzuar. Vetëm ligji gjithsesi nuk do ta bëjë këtë të mundshme, por mendojmë që qeveria duhet të sponsorizojë sa më shpejtë aprovimin e ligjit si parakusht të parë e me pasë të perkrahë;
- Institucionet në implementimin e përdorimit të nënshkrimit digjital. Secili institucion dhe ndërmarrje duhet të ketë të integruar nënshkrimin digjital me zgjedhjen që e përdorë, ose të krijojë një zgjedhje digjitale të tillë;
- Sponsorizimi dhe gjetja e formave për të krijuar një Autoritet Certifikues në Kosovë që kishte lehtësuar zbatimin e përdorimit të nënshkrimit të kualifikuar elektronik. Për sqarim sipas rregullores eIDAS autoriteti certifikues lokal nuk është i domosdoshëm dhe mund të përdoret çfarëdo autoriteti ekzistues në Bashkimin Evropian, por një i tillë do t'u mundësonte qytetarëve të Kosovës një përdorim më të lehtë dhe të shpejtë.

Ju falenderoj për vëmendjen dhe shpresoj që së bashku të tejkalojmë këtë fazë, duke nxjerrë edhe ndonjë dobi nga praktikat e kooperimit dhe koordinimit që na janë imponuar si të domosdoshme.

Avdullah Hoti: Faleminderit shumë, tani po e hapim diskutimin. Kemi edhe 10-15 minuta diskutim. Nuk desha të ju kufizoj mirëpo nëse mundeni të jeni sa më të përmbledhur, që të krijojme hapësirë edhe për të tjerët. Faleminderit.

Linda Shala: Përsëritje të gjithëve, të jemi më efektiv edhe unë pajtohem t'u japim rastin të tjerëve. Unë shkurt në emër të Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës në rend të parë, dëshiroj të përgëzoj Qeverinë në pakon e rimëkëmbjes ku është paraparë buxheti dhe vijat e veçanta në mbështetjen e biznesit të grave. Sigurisht, se ne jemi koordinuar dhe pak a shumë i dimë kërkesat dhe trajtimi i bizneseve në këtë rast që bëhet për burrat dhe gratë është mirë që të kemi disa vija të veçanta në suportin e biznesit të grave. Ajo që shkurt dua të ngris është problemi aktual i një segmenti të veçantë e që janë institucionet parashkollë private. Është një sektor i cili se bashku me HoReCa e ka përjetuar më së shumti pandeminë edhe me gjitha masat që janë marrë.

Vështirësitë e tyre po vazhdojnë edhe sot, duke marr parasysh se ky sektor punëson kryesisht gra dhe diku janë të punësuar rreth 2,000 punëtorë sipas Asosacionit të Insitucioneve Parashkollore Private, ne kërkojmë një trajtim me emergjencë të këtij sektori, sepse kemi informata nga terreni se veç kanë filluar mbylljet e çerdheve private sepse të funksionosh 6 muaj pa të hyra është shumë e vështirë.

UNICEF-i para pandemisë e ka krijuar një databazë të jashtëzakonshme për nevojat e tyre të të gjitha institucioneve parashkollore në Kosovë. Do të thotë është mirë që të mos humbim kohë në analiza dhe identifikim dhe ta shfrytëzojmë atë databazë e cila është krijuar dikur gjatë pandemisë për nevojat e kurikulës së trajnimeve, dhe të ju dalim me një ndihmë sa më emergjente këtyre institucioneve. Duke e marr parasysh nurmin e vogël të çerdheve publike që i kemi, fakti që faktor i pjesëmarrjes së ulët të grave në tregun e punës është pikërisht mungesa e çerdheve, atëherë çdo mbyllje e çerdheve private shkakton dëme të shumëfishuara. Prandaj, duke e marr parasysh që besoj se ka vullnet pasi është rishikuar buxheti dhe kanë kaluar marrëveshjet ndërkombëtare, ka mjete të cilat mund të përdoren pa prituri të kalohet ligji për rimëkëmbje ekonomike. Të gjejmë modalitet sepse është sektor i vogël dhe të shpëtojmë atë që mundet me u shpëtu. Faleminderit.

Avdullah Hoti: Ju faleminderit. Diskutime tjera nuk ka. Nëse jeni dakord, po ia kaloj fjalën znj. Daija dhe pastaj dalim tek pjesa përfundimtare ku do të mundohem të jap disa sqarime për çështjet që u ngritën.

Lindita Daija: Faleminderit z. Kryeministër. Së pari më vjen mirë që jeni kthyer me shëndet të mirë. Së dyti ju falendëroj për bashkëpunimin e ngushtë gjatë gjithë kësaj kohe në riorganizimin e Këshillit dhe besoj që pasi kemi bërë riorganizimin në nivel të dikastereve qeveritare do të vazhdojmë së bashku me sektorin privat të bëjmë riorganizimin e Odave dhe përfaqësimin e tyre dhe takime të përbashkëta përmes Sekretariatit. Po ashtu, Sekretariati në këtë takim të rradhës, pasi që ishte një lloj takimi konstituiv, nuk ka dashur të marr kohë dhe t'u jap prioritet odave apo përfaqësuesve të sektorit privat. Siç e dini ne kemi përgatitur tri raporte analitike, që është: ndikimi ekonomik gjatë pandemisë, ndikimi i problemeve ligjore në aspektet kontraktuale dhe në bankrotim, si dhe kemi dhënë një propozim për masat e propozuara qysh në muajin mars. Për shkak që këto raporte janë prezentuar një herë nuk do marrim kohë dy herë. Në anën tjetër jemi takuar me ministrat kyç që t'i informojmë mbi këto të gjetura dhe planifikojmë të kemi takime individuale sa i përket masave dhe kërkesave të odave në mënyrë që kur të vijmë në takim të Këshillit, të vijmë me rekomandime konkrete. Këto janë planet e Sekretariatit në pika shumë të shkurta, do të thotë do vazhdojmë me odat t'i takojmë ministrat e linjës me temat e ndërlidhura me rimëkëmbje.

Në pikën e dytë, si pasojë e këtyre ndryshimeve kemi riplotësuar rregulloren e punës si dhe vendimin për grupin koordinues që e kemi dorëzuar tek ju dhe besojmë që pas këtij takimi konstituiv mund të vazhdojmë punën e detajizimit të masave përmes këtyre strukturave. Në

aspektin tematik, më vjen mirë që odat po tregohen partnere të denjë ndaj qeverisë duke dhënë rekomandime shumë kyçe, po ashtu më vjen mirë që është potencuar qartë çështja që gjatë rimëkëmbjes të shfrytëzohet rasti të bëhet edhe transformimi ekonomik dhe mund te pajtohem me të gjitha deklaratat ku u tha që është koha që ekonomia jonë të përparojë, të digjitalizohet dhe të transformohet duke e shfrytëzuar kohën e rimëkëmbjes—dhe me vjen mirë që ju si Kryeministër i Kosovës e shihni sektorin privat dhe përfaqësuesit e tyre si parnterë kyç në këtë proces. Ju faleminderit shumë.

Avdullah Hoti: Faleminderit znj. Daija. Atëhere nëse më lejoni unë po nxjerr disa përfundime dhe nëse kemi pastaj ndonjë sugjerim qoftë të adresojmë konkluzionet, përfundimet e këtij takimi dhe gjatë tyre do mundohem të japë përgjigje në çështjet që u ngriten duke qenë i vetëdijshëm që ndoshta nuk mund të përgjigjem në të gjitha çështjet.

E para, me atë që kuptova prej diskutimeve, sigurisht edhe në fjalën time isha plotësisht i gatshëm që të ketë përfshirje të plotë të odave, shoqatave, grupeve të interesit në dizajnimin e kritereve dhe në shpërndarjen e mjeteve nga masat e rimëkëmbjes ekonomike. Në bazë të vendimit të Qeverisë ne kemi shpërndarë mjete në masa, ministrat tani duhet të përgatisin kriteret për shpërndarjen e atyre mjeteve dhe unë kërkoj përfshirjen e juaj në ministrinë përkatëse varësisht prej interesit tuaj. Formalisht, me vendimet e ministrave përkatës ku janë zyrtarët e ministrisë dhe ku janë përfaqësuesit e odave ekonomike për të përcaktuar këto kritere dhe madje në komisionet për vlerësimin e aplikimeve që vijnë për të përfituar nga këto mjete, përveç pjesës së bujqësisë, sepse ato janë subvencione me të cilat merret Ministria e Bujqësisë.

E dyta ishte sugjerim, apo vërejtje, që mjetet të shpërndahen sa më parë, gjatë shtatorit dhe tetorit të futen të gjitha këto mjete në ekonomi, ky është edhe plani jonë. Mirëpo, një pjesë e mjeteve që i kemi paraparë janë të lidhura me ligjin për rimëkëmbjen ekonomike, janë 100 milion prej AKP-së, Fondit për Privatizimin prej të cilave 50 i marrim, por janë dhe 50 tjera të cilat vetëm kur ndryshon ligji mund t'i marrim. Nëse ndryshon ligji gjatë shtatorit mund t'i përfundojmë, nëse nuk ndryshon—atëherë duhet në tre-mujorin e fundit, kur të hyjmë në tetor e tutje, me balancin përfundimtar të buxhetit të shikojmë si mund ta kompenzojmë këtë pjesë. Përtej kësaj, me Ministrinë e Financave po planifikojmë që këtij fondi prej 365 milion euro në javët/muajt e fundit të vitit kur të përmbyllen të gjitha pagesat, nëse ka tepriçë që mjeteve në projekte të ndryshme, varësisht prej asaj që na lejon ligji për të bërë ri-alokimet e nevojshme, të qesim mjete shtesë në këtë fond në mënyrë që përveç atij limitit të deficitit që kemi të shfrytëzojmë edhe mjetet tjera për rimëkëmbje.

E treta, pako e rimëkëmbjes ekonomike është më se e qartë që detyrimisht do jetë pjesë e buxhetit për vitin 2021. Për këtë KASH-i, është ndoshta hera e parë që korniza e afatmesme duhet të rishikohet besoj deri në fund të gushtit apo fillim të shtatorit të përfundohet si çështje dhe brenda saj duhet të jepen orientimet për një fond për rimëkëmbje ekonomike. Është herët të

flasim për shumën e atij fondi mirëpo duket që do të jetë prapë signifikant duke qenë se po vazhdon kjo situatë.

E katërta, situata ekzistuese të shfrytëzohet si mundësi për ristrukturim të ekonomisë dhe pajtohemi plotësisht se është mundësi e mirë që në shtator kur të fillojmë punën në strategjinë zhvillimore të kemi një perspektivë pak më afatgjatë të riorganizimit të politikave dhe të ekonomisë duke u orientuar kah eksporti, prodhimi, shërbimet digjitale dhe çështje tjera që ministrat përkatës i kanë në resortet e tyre por do i diskutojmë prapë këto kur të vijmë në shtator.

E pesta, kërkoj që në takimin e rradhës (daten mund ta vendosim se shpejti, ndoshta në fillim të shtatorit pas një konsultimi që mund të bëjmë) ministrat të raportojnë për këto sugjerime/vërejtje që i morren tash dhe po ashtu për mënyrën se si do të adresojnë rekomandimet e sektorit privat për rimëkëmbje ekonomike me materialin që e ka përgatitur Sekretariati. Tash u informova që është përgatitur koncepti i dokumentit për ligjin për prokurimin. Mendimi im personal është që nuk jam i sigurt deri në çfarë mase ne mund të fusim nënë ku i favorizojmë kompanitë vendore, ndoshta mund ta lidhim vetëm me kohën e pandemisë për aq kohë sa është në fuqi vendimi i situatës emergjente shëndetësore, ndoshta diçka të tillë mund të bëjmë. Pra pasi koncepti i dokumentit është gati, ligji mund të jetë gati në shtator.

Akciza, pra kalendari i akcizave për duhan, lëngje dhe vetura hibride, janë marrë në Qeveri dhe janë dërguar në Komisionin Parlamentar për Financa; nuk kanë kaluar, ndoshta edhe për shkak të mungesës së informatave që kanë pasur deputetët mbi to. Unë kam kërkuar sqarim ligjor nga zyra jonë ligjore brenda zyrës së kryeministrit, sepse ligji nuk është plotësisht i qartë. Ligji thotë: “Miratohen në Qeveri me informim të Komisionit për Buxhet dhe Financa” dhe nuk është e qartë nëse veç i dërgohet komisionit për buxhet për konsultim apo kërkohet votim formal i komisionit në mënyrë që kjo të hyjë në fuqi. Interpretimi im, edhe pse nuk jam jurist, është që këto kalojnë në Qeveri dhe mandej pas diskutimit në komision, pavarësisht mendimit të komisionit këto hyjnë në fuqi. Po besoj shpejtë do ta kemi një përgjigje. Nëse përgjigja është që këto duhet të kalojnë me shumicë të votave në komision, ne do të miratojmë edhe njëherë në Qeveri dhe do i dërgojmë prapë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe besoj që rreth 15 shtatorit duhet të kalojnë në komision. Unë jam i bindur që kalojnë dhe mobilizohemi me anëtarët tonë që i kemi në komision si shumicë parlamentare, si qeveri të kalojnë.

Tek dialogu social lidhur me pagën minimale, nuk e di nëse keni pasur me shpejtë ndonjë takim me Këshillin Ekonomik Social. Pas diskutimeve që i keni atje besoj se ministrat përkatës na informojnë dhe shohim mandej z. Shahini se si mund të vazhdojmë. Por, një gjë me aq sa kam unë informata, nuk ka kompani private që i paguan punëtorët me pagë minimale, gati që nuk ka. Pra, nënkupton që kjo pagë minimale me ligj është bukur efektive, abstrakte, në leter vetëm, por që ka hapësirë për me u rishiku duke qenë gjithmonë të kujdesshëm dhe duke i zbatuar ato katër indikatorët në bazë të cilëve bazohet paga minimale.

Tek mbështetja për gratë dhe komunitetet tjera që janë në kushte pak më të vështira, e keni parë vendimin e Qeverisë, ne e kemi ndarë 2 milion për zyrën për barazi gjinore dhe jam plotësisht dakort që të gjenden forma sa më të lehta që këto mjete të hyjnë në ekonomi për mbështetje për gratë në biznes. Ndoshta forma më e mirë është që të shkojnë një pjesë për institucionet parashkollore duke qenë se, me sa kam dijeni, kryesisht janë punëtore femra, që kanë edhe efekt multiplikues tek lirimi i femrave për tregun e punës, etj. Unë ju sugjeroj që të uleni me Drejtoreshen e Zyres për Barazi Gjinore këtu në zyrën e Kryeministrit dhe të shihni se si mund të procedojmë. Ne jemi të gatshëm që menjëherë të shkojmë përpara dhe gjithashtu me MCC ka paraparë shumë prej 2 milion euro shtesë për biznese të grave. Kemi biseduar me MCC-në që t'i bëjmë fondet bashkë dhe të përdoren ndoshta të njëjtat procedura që veç i ka zhvilluar MCC, për t'i ndihmuar bizneset e grave që ne t'i shtojmë edhe këto mjete.

Ju informoj gjithashtu, Zv. Kryeministri e përmendi, që kemi nda për komunat 10 milion nga pakoja e rimëkëmbjes dhe 29 milion që kanë qenë tek komunat si kontingjencë për ligjin e pagave i cili nuk hyri në fuqi. Pra, këtë shumë prej 39 milion e kanë në dispozicion komunat për të menaxhuar me pandemie e këtu, me të drejtë e tha Zv. Kryeministri që mund të përdoret edhe për të ndihmuar bizneset lokale. Ju keni deget e juaja nëpër komuna të ndryshme, mirë është që ndoshta të takoheni me Asocionin e Komunave, kryetarët e Komunave që të kërkonin që një pjesë e këtyre fondeve që kanë me u shfrytëzuar në masë të madhe për arsim në shkolla, dezinfektime, pajisje e tjera dhe në shëndetësi primare të shfrytëzohen edhe për bizneset lokale dhe hotelierisë në veçanti.

Kjo skema e voucher-eve, unë jam mbështetës shumë i madh i saj dhe po pres që ministrat të vijnë me propozime konkrete për skema të ndryshme të voucher-eve. Njëra ndër skemat që kemi diskutuar dhe po pres që të vijë propozimi konkret, është që familjet me asistencë sociale të marrin voucher për të shpenzuar në produkte të caktuara ushqimore që janë me prodhim vendor. Është skemë e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, që mund të zbatohet.

Dhe e fundit, me lejen tuaj, besoj materialet do ju dërgojë znj. Daija përmes e-mailit në lidhje me propozim-vendimin dhe projekt rregulloren e Këshillit dhe brenda katër (4) ditëve mund të dërgoni ndonjë vërejtje ose sugjerim që keni për të adresuar. Në perputhje me ato vërejtje apo sugjerime, unë do i nënshkruaj dhe janë pastaj të gatshme për mbledhjen tonë të ardhshme.

Nëse nuk ka ndokush ndonjë intervenim apo plotësim për këto konkluzione që i prezentova para jush, nëse jo atëherë ju falenderoj për prezencën deri në takim të ardhshëm.